

|                                                                                   |                                              |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
| Vendndodhja: Butrint                                                              | Tenderi № : 020/2025                         |
| Projekti: “Rehabilitimi i Biletarisë & Tualetëve në Parkun Kombëtar të Butrintit” | Data e dorëzimit: 24 Shtator 2025, Ora 11:00 |

## Termat e Referencës

për

***“Rehabilitimi i Biletarisë & Tualetëve në Parkun Kombëtar të Butrintit”***



Gusht 2025

|                                                                                          |                                                     |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| <b>Vendndodhja:</b> Butrint                                                              | <b>Tenderi № :</b> 020/2025                         |
| <b>Projekti:</b> “Rehabilitimi i Biletarisë & Tualeteve në Parkun Kombëtar të Butrintit” | <b>Data e dorëzimit:</b> 24 Shtator 2025, Ora 11:00 |

## Sfondi

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit (FMB) është themeluar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe Fondacioni Shqiptar-Amerikan për Zhvillim (AADF) si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim në formën e “fondacionit”.

FMB vepron në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në mënyrë specifike qëllimi i saj është administrimi indirekt i nënzoneve të trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit, një pasuri me vlerë universale, në përputhje me Ligjin Nr. 50/22 *“Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”*.

Qëllimet e FMB janë të administrojë, ruajë dhe mbrojë asetet e trashëgimisë kulturore të Sitit të Trashëgimisë Botërore të Butrintit. Misioni i Fondacionit është të sigurojë akses publik dhe shërbime, si dhe të promovojë aktivitete studimore dhe kërkimore. Ky mision do të realizohet duke menaxhuar dhe zhvilluar pasurinë kulturore në mënyrën më të mirë të mundshme, duke siguruar mjetet financiare të nevojshme dhe personelin e specializuar për ruajtjen dhe zhvillimin e saj gjatë gjithë kohëzgjatjes së administrimit indirekt nga FMB.

Në zbatim të Planit të Menaxhimit të Integruar 2020-2030, FMB përgatiti Planin dhe Studimin për Menaxhimin e Trafikut, Transportit dhe Vizitorëve dhe Planin e Shëndetit dhe Sigurisë në Parkun Kombëtar të Butrintit. Qëllimi i këtyre planeve ishte të kryenin një vlerësim të kushteve ekzistuese sipas fushës përkatëse që mbulonte secili prej tyre dhe të ofronin rekomandime për të përmirësuar infrastrukturën turistikë dhe të shërbimit të vizitorëve.

## Baza Ligjore

- Ligji 27/2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1125, datë 30.12.2020 për “Miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1099, datë 24.12.2020 për “Miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”.
- Vendimi i KKTKM, Nr. 527, Datë 13.12.2024 për miratimin e “Manualit të Restaurimit”.

|                                                                                          |                                                     |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| <b>Vendndodhja:</b> Butrint                                                              | <b>Tenderi № :</b> 020/2025                         |
| <b>Projekti:</b> “Rehabilitimi i Biletarisë & Tualetëve në Parkun Kombëtar të Butrintit” | <b>Data e dorëzimit:</b> 24 Shtator 2025, Ora 11:00 |

## Përshkrimi i zonës

1. Biletaria e Parkut Kombëtar të Butrintit është një godinë prej druri e ndërtuar në vitin 2012 nga AADF (Fondacioni Shqiptaro Amerikan për Zhvillim). Nisur nga kushtet në të cilat duhet të funksionoj sistemi i ri i biletarisë bën të domosdoshëm faktin që godina aktuale nuk i përmbush kriteret e duhura për shkak të amortizimit në vite dhe mungesës së mirëmbajtjes. Përsa i përket anës konstruktive të godinës vërehen qartë probleme të qëndrueshmërisë së strukturës dhe nevojës për rikonstruksion dhe zëvendësim të elementëve të objektit.
2. Tualetet e Parkut Kombëtar të Butrintit janë një Strukturë prej druri e ndërtuar në vitin 2015. Struktura aktuale nuk i përmbush kriteret e duhura për shkak të amortizimit në vite dhe mungesës së mirëmbajtjes për këtë arsye paraqitet i domosdoshëm rikonstruksioni. Përsa i përket anës konstruktive të godinës vërehen mjaft qartë probleme të qëndrueshmërisë së strukturës dhe nevojës për rikonstruksion dhe zëvendësim të elementëve të objektit. Tualetet kanë nevojë për një rampë për të siguruar aksesin për personat me aftësi të kufizuara.

## Qëllimi dhe objektivat kryesorë

Qëllimi i rikonstruksionit është “Të përmirësohet infrastruktura turistike nëpërmjet ndërhyrjes rinovuese për aplikimin e kushteve që sigurojnë standard për vizitorët e huaj dhe vendas që vizitojnë Parkun e Butrintit dhe stafit të FMB-së”.

### Objektivat e projektit të investimit

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë ambiente të restauruara dhe të përshtatura në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veprimtarisë për shërbimin e integruar turistik, në respektim të standardeve bashkëkohore .

Objektivat specifikë të këtij projekti investimi përmbledhen në vazhdim:

- Përshtatshmëria funksionale dhe komoditeti i ambienteve, në përputhje me kërkesat dhe standardet bashkëkohore.
- Plotësimi i ambienteve me sisteme, pajisje, rrjete bashkëkohore.
- Rinovimi dhe rruajtja e strukturës ekzistuese të biletarisë.
- Përmbushja e kriterëve infrastrukturorë për eficientë energjetike, komoditetin termoakustik, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

## Kërkesat për Aplikantët

1. Licence restaurimi për subjektin juridik në zbatim me kategorinë N-Z/A/1 dhe drejtuesi teknik me kategorinë Z/A/1 (Punime në site arkeologjike).
2. Licencë për ushtrimin e veprimtarisë ndërtuese zbatimi kategoria NP-1, klasifikimi A, kategoria NS-4, klasifikimi A.
3. Ekipi Kryesor do të përbëhet nga të paktën këto pozicione individuale:
  1. Drejtuesi Teknik (Restaurator);
  2. Arkitekt;
  3. Teknik Ndërtimi me diplomë të arsimit të mesëm;

|                                                                                          |                                                     |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| <b>Vendndodhja:</b> Butrint                                                              | <b>Tenderi № :</b> 020/2025                         |
| <b>Projekti:</b> “Rehabilitimi i Biletarisë & Tualetëve në Parkun Kombëtar të Butrintit” | <b>Data e dorëzimit:</b> 24 Shtator 2025, Ora 11:00 |

4. Arkitekt ose Inxhinier i certifikuar për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë HSE;
  5. Inxhinier i pajisur me certifikatë për ushtrimin e profesionit Ekspert Zjarrfikës.
4. Ofruesi i Shërbimit duhet të ketë në stafin e tij:
- a. 1 (një) punonjës të certifikuar për “*Punime në lartësi*”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
  - b. 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, (I ndryshuar).
  - c. Gjithashtu duhet të ketë në stafin e tij specialistet e mëposhtëm:
    1. Marangoz
    2. Karpentier
    3. Bojaxhi
    4. Elektriçist

Punonjësit e përcaktuar në pikën 4. të jenë të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. Punonjësit e sipërpërmendur të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e 6 muorit të fundit të vitit në vazhdim.

**Shëndeti dhe siguria:** I gjithë personeli i përfshirë në punime duhet të respektojë protokollet e shëndetit dhe sigurisë, duke përfshirë përdorimin e pajisjeve të përshtatshme për mbrojtjen personale (PPE) dhe ndjekjen e udhëzimeve të veçanta për sigurinë në vendin e punës.

## Dokumentacioni i Tenderit:

**Për marrjen e dokumentacionit të tenderit si më poshtë dërgoni kërkesën tuaj në email-in [tenders@bmf.al](mailto:tenders@bmf.al) :**

1. Projekt Zbatimi
2. Grafik Punimesh
3. Preventiv
4. Relacion Teknik
5. Specifikime Teknike

## Komunikimi gjatë tenderit

Gjatë periudhës së tenderit komunikimi për pyetje do të bëhet vetëm nëpërmjet e-mail-it në adresën [tenders@bmf.al](mailto:tenders@bmf.al)

|                                                                                          |                                                     |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| <b>Vendndodhja:</b> Butrint                                                              | <b>Tenderi № :</b> 020/2025                         |
| <b>Projekti:</b> “Rehabilitimi i Biletarisë & Tualeteve në Parkun Kombëtar të Butrintit” | <b>Data e dorëzimit:</b> 24 Shtator 2025, Ora 11:00 |